



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E LIPJANIT

SHFMU “KATËR DËSHMORËT” – KROJMI

HISTORIKU I SHKOLLËS

SHFMU “Katër Dëshmorët” – Krojmir, është institucion edukativo-arsimor.

Në Krojmir, fëmijët e fshatit mësimet e para i morën nga viti 1947. Mësimi zhvillohej nëpër oda të fshatit Krojmir dhe në kushte të vështira.

Mësuesi i parë ishte Nezir Gashi, ndërsa mësuesi i parë vendas ishte Abdyl Meta.

Në vitin 1953, me iniciativën e banorëve fshatit dhe me punë vullnetare u ndërtua një shkollë e vogël dy klasëshe.

Në fillim shkolla e Krojmirit ishte e organizuar në kuadër të Shalës, mirëpo që nga viti 1986, shkolla e Krojmirit ishte e organizuar në kuadër të shkollës së Pjetërshiticës.

Që nga viti 1994, shkolla e Krojmirit funksionon si shkollë e pavarur dhe gjithashtu në kuadër të kësaj shkolle funksionon edhe paralelja e ndarë në Pojatë, e cila është ndërtuar nga vet banorët e fshatit, ku nxënësit vijnë në mësimin deri në klasën e katërt.

Pas vitit 1994, lindi initiative për ndërtimin e shkollës së re nga fshatarët, të cilët me vetkontribut financiar ndërtuan muret e kësaj shkolle.

Mirëpo, përrurimi dhe funksionalizimi i shkollës së re u bë me 1 shtator të vitit 2000 nga Shoqata humanitare “ADRA” nga Danimarka.

Poashtu, edhe shkolla në paralelën e ndarë në Pojatë u rinovua dhe u përshtat për mësim në vitin 2000, nga Shoqata “CECI” nga Kanadaja.

Shkolla e Krojmirit më parë quhej “Faik Konica”, mirëpo me një vendim të MASHT-it, i cili bazohej në kërkesën e shkollës dhe fshatit në përgjithësi, vendosët që nga viti 2008, shkolla e Krojmirit të quhej “Katër Dëshmorët”.

Me këtë emër pagëzohet për nder të katër Dëshmorëve të fshatit, Halil Meta, Enver Olluri, Isa Olluri dhe Qamil Olluri, të cilët ishin edhe nxënës të kësaj shkolle, dhe të cilët ranë heroikisht në

luftën e fundit të UÇK-së në Kosovë. Për nder të Dëshmorëve, në oborrin e shkollës është ngritur edhe pllaka përkujtimore për 4 Dëshmorët.

Sot, shkolla e Krojmirit ka 215 nxënës, 15 paralele, 21 mësimdhënës, 4 punëtor teknik dhe Drejtorin, duke përfshirë edhe paralelen e ndarë në Pojatë.

Në vitin 2019, nga Qeverisja komunale e Lipjanit, shkolla e Krojmirit është rinovuar tërësisht brenda dhe jashtë dhe është sjellur inventari i ri shkollor, ku shkolla ka marr pamje krejtësisht tjetër, me kushte dhe klimë më të mirë për mësimnxënie dhe mësimdhënie.

Objekti i shkollës ka 7 klasë mësimi, 1 zyre për mësimdhënës, 1 bibliotekë, 1 kabinetë biologji-kimi, zyrën e drejtorit dhe 2 zyre për punëtor teknik dhe toaletet.

Në oborrin e shkollës, gjendet fusha e sportit dhe depo për dru.

Paralelja e ndarë në Pojatë ka 2 klasë mësimi dhe zyrën e mësimdhënësve.

Mësimi në të dy shkollat zhvillohet në dy ndrrime.

Me respekt,

Drejtori i shkollës: Shqipërim Qeriqi